



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 184, datë 22.12.2023

PËR MIRATIMIN E DETAJIMIT TË SHITESËS SË FONDEVE TË RINDËRTIMIT PËR VITIN 2023 AKORDUAR NË FORMËN E TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTEA PALLAT DHE NJËSI INDIVIDUALE, DURRËS

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Lgjit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 682, datë 6.12.2023 “Për një shtesë në Vendimin nr.255, datë 29.4.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat) në Bashkinë Durrës”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 690, datë 6.12.2023 “Për një shtesë në Vendimin nr. 181, datë 30.3.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në bashkitë Tiranë, Durrës, Shijak, Lezhë dhe Krutë”, të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, të Udhëzimit Plotësues nr. 2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore”, si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e përdorimit dhe detajimit të shtesës së fondeve të rindërtimit për vitin 2023, alokuar në formën e transfertës së pakushtëzuar për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa pallat dhe njësi individuale, sipas tabelës së mëposhtëme :



Nr.	Emërtimi i Projektit	Kodi i programit	Llograia Ekonomike	Kodi i Produktit	Financimi shtesë për vitin 2023
1	Riforcimi njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe njësive individuale të banimit	04960	231	94902AB	2,706,253,897

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi




U shpall sot me datë 22.12.2023





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS


Nr. 926 prot.
2

Durrës, më 22.12.2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TËBASHKISË
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.184 datë 22.12.2023 “Për miratimin e detajimit të shtesës së fondeve të rindërtimit për vitin 2023 akorduar në formën e transfertës së pakushtëzuar për financimin e rforcimit të njësive të banimit në ndërtesa pallat dhe njësi individuale, Durrës”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

